



# UNIVERSITETI I SHKODRES

## “Luigj Gurakuqi”

Nr. 3525 Prot.

Shkodër, më 10.10.2016

### NJ O F T I M

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” shpallet konkursi për një vend të lirë pune në **Fakultetin e Shkencave të Natyrës**, Departamenti i Fizikës, për pozicionin lektor/e me kohë të plotë për lenden “Fizikë e përgjithshme”,

#### Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere :

- Të kenë kryer shkollen pasuniversitare me diplomë “Master Shkencor” ose gjatë studimeve universitare dhe pasuniversitare të kenë grumbulluar jo më pak se 300 kredite në fushën e “Fizikës”, me notë mesatare jo më të ulët se 8.5. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga MAS-i.
- Të kenë kryer arsimin e lartë në sistemin me kohë të plotë, në profilin “Fizikë” me notë mbi 8.5.
- Nota mesatare e përgjithshme e studimeve në diplomën e sistemit të vjetër të jetë mbi 8,5.
- Të kenë noten mesatare të grup-lëndëve të “Fizikës së Përgjithshme” jo më pak se 9.
- Të ketë përfunduar studimet “MSH” në fushën e “Fizikës” me kohë të plotë, me notë mesatare jo më të ulët se 8.5.
- Të njohë një gjuhë të huaj perëndimore (preferohet anglisht) me notë jo më të ulët se 8 ose të ketë mbrojtur një nga pesë gjuhët e njohura nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për gjuhët në nivelin C1.
- Të kenë dhënë provim universitar dhe/ose pasuniversitar lëndën për të cilën pretendojnë të jenë lektorë.
- Preferohen që kandidatët të kenë:
  1. gradën “Doktor i Shkencave” apo titull akademik “Prof. , prof.as.dr. , docent” etj
  2. eksperiencë pune në mësimdhënie në shkollen e lartë,
  3. të kenë aktivitet botues.
- Shtetasit e huaj duhet të kenë leje pune dhe leje qëndrimi.

#### Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumente :

1. Kërkesë me shkrim për aplikim.
2. Jetëshkrim (CV) me foto personale.
3. Dëshmi Doktorature, MND ose DND dhe e provimeve pasuniversitare (lista e notave) të njohura zyrtarisht. Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga MAS-i.
4. Diplomë të Shkollës së Lartë ose fotokopje dhe lista e notave (të noterizuara).
5. Dy rekomandime nga mësimdhënës me tituj shkencorë në profilin për të cilin konkurohet.
6. Fotokopje të artikujve të botuar, teksteve universitare apo parauniversitare, projekte shkencore, punime të tjera.
7. Dëshmi e gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore.
8. Dëshmi për kualifikime të ndryshme, pjesëmarrje në konferanca, seminare, workshopë etj.
9. Dëshmi e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) dhe mjekësore (kartë shëndeti+librezë shëndetsore).
10. Vërtetim nga qendra e punës në të cilën ka punuar ose punon dhe/vetëm papunësie nga Zyra e Punës.
11. Deklaratë që provon kushtet e pikës 3/c të nenit 8 të Rregullores së posaçme të Universitetit për Zënien dhe Ruajtjen e vendit të punës (për moslidhje farefisnore).
12. Çertifikatë familjare dhe dokument identifikimi vetjak (fotokopje pasaporte, letërnjoftimi ID).
13. Listë përmbledhëse e dokumenteve të dorëzuara nga konkurrenti.
14. Çdo dokument tjetër që vërteton kërkesat e mësipërme.

#### Shënim:


- Kontrata e punës do të jetë me afat 1-vjeçar (vit akademik) me të drejtë rinnovimi.
- Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Degës së Burimeve Njerëzore ose Sektorit të Protokoll-arkivës dokumentacionin e mësipërm deri më datë 29.10.2016, ora 12<sup>00</sup>.



- Konkursi do të zhvillohet me dosje, dhe/ose testim, dhe/ose intervistë me datë 31.10.2016, sipas orarit që do të përcaktojë Departamenti Fizikës.
- Kandidatët që kualifikohen do të njoftohen me e-mail nga kryetari i komisionit ad-hoc deri më 05.11.2016.
- Për hollësi të mëtejshme, si programi, mënyra e zhvillimit të konkursit dhe ora e saktë, t'i drejtoheni Departamentit të Fizikës dhe/ose Degës së Burimeve Njerëzore.

Rektorati i Universitetit të Shkodrës

“Luigj Gurakuqi”



Universiteti i Shkodrës  
“Luigj Gurakuqi”

